REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1463 Prot. Korçë,më 10.08.2026

VENDIM

Nr.344, datë 10.08.2026

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027 – 2029
TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", Korce i mbledhur ne daten 10.08.2026, per miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2027 – 2029, ne mbeshtetje te ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, ligjit nr.10296, date 8.7.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", te ndryshuar, ligjit nr.87/2025 "Per buxhetin e vitit 2026", te ndryshuar, udhezimin nr.7, date 28.02.2018, te Ministrit te Financave "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem", si dhe standardeve te percaktuara ne shtojcen nr. 1/A, te udhezimi nr.15, date 07.07.2026, te Ministrit te Financave "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem 2027-2029", shkreses Nr.5396/1 date 15.07.2026 te Ministrise se Arsimit "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem 2027-2029",

VENDOSI:

1. Te miratoje Programit Buxhetor Afatmesem 2027-2029 te Universitetit "Fan S. Noli" Korce.

Ky vendim hyn ne fuq i menjehere

KRYETAR I SENATIT

REKTORI

Prof. Dr. Lorenc EKONOMI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 1632 **prot** **Korçë, më** 10 / 09 / **2026**

**VENDIM**

**Nr.** 379 **, datë** 10 . 09 **.2026**

**PËR**

**PËRSHTATJEN E KUOTAVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", si dhe VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të*", i ndryshuar, pika 2.7 gërma b) "*Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet nga IAL-të në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore*", në Udhëzimin Nr. 12, datë 30.06.2023, "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", i ndryshuar Kreu II, shkronja E, pika 4, si dhe urdhrit të përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 108, datë 15.06.2026, "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL për vitin akademik 2026-2027*" Senati Akademik pas shqyrtimit të propozimit të njësive bazë, në mbledhjen e datës 10.09.2026,

**VENDOSI:**

1- Përshtatjen e kuotave, mbështetur në totalin e kuotave të deklaruar nga njësitë kryesore, për programet e studimit për vitin akademik 2026-2027 sipas tabelës bashkëngjitur:
2- Në Fakultetin e Bujqësisë programit të studimit "Bachelor" në "Menaxhim Agrobiznesi" i shtohen 3 kuota në kategorinë (për program të dytë studimi që shkon në total si kategori 5 kuota). Këto kuota i zbriten kuotave të të njëjtit program studimi (shqiptarë brenda vendit që shkon në total si kategori 22 kuota).
3- Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për arsim parashkollor" i shtohen 2 kuota në kategorinë (*për program të dytë studimi* që shkon në total si kategori 5 kuota). Këto kuota i zbriten kuotave të të njëjtit program studimi kategorisë "*shqiptarë brenda vendit*" dhe shkon në total si kategori 15 kuota.
4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@unkorce.edu.al

| Nr | IAL | Fakulteti | Programi i studimit | KAPACITETET PRITËSE | SHUMA E KUOTAVE | Shqiptarë brenda vendit | Që aplikojnë për program II | Që aplikojnë për Transferim studimesh | Të huaj | Me statusin e jetimit | Persona me aftësi të kufizuar | Romë + balkano egjiptian | Trojet (Kosovë / Maqedoni / Mal i Zi / Preshevë / Bujanovc / Medvegjë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Kuotat sipas programit të studimit për kandidatët: | | | | | | | |
| 1 | Universiteti "Fan S. Noli", Korçë | Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane | Program profesional 2- vjeçar "Shërbim Social" | 80 | 45 | 40 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 2 | 1 |
| 2 | | | "Bachelor" në "Shkenca Politike" | 45 | 32 | 22 | 4 | 2 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 3 | | | "Bachelor" në "Administrim dhe Politika Sociale" | 74 | 45 | 35 | 5 | 1 | 0 | 2 | 0 | 1 | 1 |
| 4 | | | "Bachelor" në "Inxhinieri Informatike"(Program i përbashkët) | 60 | 35 | 25 | 5 | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 5 | | | "Bachelor" në "Teknologji Informacioni" | 91 | 50 | 40 | 4 | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 |
| 6 | | | "Bachelor" në "Data Science" | 25 | 25 | 15 | 4 | 2 | 2 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 7 | | | "Bachelor" në "Matematikë-Fizikë" | 37 | 25 | 15 | 5 | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 8 | | | "Bachelor" në "Infermier i përgjithshëm" | 239 | 84 | 75 | 2 | 5 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| 9 | | | "Bachelor" në "Mami" | 92 | 34 | 30 | 2 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| 10 | | | "Bachelor" në "Biologji- Kimi" | 40 | 25 | 15 | 4 | 4 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 11 | | | "Master Profesional" në "Administrim Publik" | 30 | 30 | 20 | 5 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 |
| 12 | | | "Master Profesional" në "Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit" | 25 | 25 | 15 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 |
| 13 | | | "Master Profesional" në "Infermieristikë" | 50 | 50 | 45 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 3 | 0 |
| 14 | | | "Master i Shkencave" në "Etika dhe Lidershipi" | 52 | 25 | 15 | 5 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 15 | | | "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Matematikë-Fizikë" | 36 | 25 | 10 | 10 | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 16 | | | "Master i Shkencave" në "Mësues i Shkencave Sociale" | 25 | 25 | 10 | 12 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| 17 | | | "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Biologji-Kimi" | 36 | 25 | 10 | 10 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 |
| 18 | | | "Master i Shkencave" në "Statistikë e Aplikuar" | 33 | 20 | 10 | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 19 | | | "Master i Shkencave" në "Shkenca Kompjuterike"(Program i përbashkët) | 25 | 25 | 20 | 3 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| 20 | | | **"Doktoratë" në "Teknologji të Avancuara dhe Zbatime të Inteligjencës Artificiale në Kërkimin Ndërdisiplinor" | 7 | 7 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 21 | | Fakulteti i Ekonomisë | Program profesional 2- vjeçar "Asistent Menaxher" | 96 | 50 | 45 | 0 | 0 | 0 | 2 | 1 | 2 | 0 |
| 22 | | | "Bachelor" në "Informatikë Biznesi" | 61 | 35 | 28 | 2 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 23 | | | "Bachelor" në "Ekonomiks" | | | | | | | | | | |
| 24 | | | "Bachelor" në "Financë - Kontabilitet" | 156 | 83 | 68 | 4 | 5 | 0 | 2 | 2 | 2 | 0 |
| 25 | | | "Bachelor" në "Menaxhim" | 97 | 60 | 50 | 2 | 4 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 26 | | | "Bachelor" në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" | 54 | 45 | 34 | 3 | 5 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 27 | | | "Bachelor" në "Administrim Biznesi në Marketing" | 101 | 55 | 44 | 3 | 5 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 28 | | | "Master profesional" në "Bankë dhe Sigurime" | 42 | 30 | 25 | 2 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 29 | | | "Master profesional" në "Administrim Biznesi" | 40 | 40 | 33 | 3 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 30 | | | "Master profesional" në "Financë - Kontabilitet" | 45 | 45 | 40 | 2 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 31 | | | "Master profesional" në "Menaxhim i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve" | 35 | 35 | 28 | 4 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 32 | | | "Master profesional" në "Marketingu Digjital" | 35 | 35 | 28 | 4 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 33 | | | "Master i Shkencave" në "Turizmi SMART dhe Zhvillimi Rajonal" | 15 | 15 | 8 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 34 | | | "Master i Shkencave" në "Financë" | 33 | 25 | 20 | 3 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 35 | | Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë | Program profesional 2- vjeçar "Mbështetës Zyre për Komunikim Bibliotekë dhe Arkiv" | 48 | 30 | 20 | 0 | 0 | 0 | 2 | 4 | 4 | 0 |
| 36 | | | Program profesional 2- vjeçar "Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme" | 48 | 25 | 20 | 1 | 1 | 0 | 2 | 0 | 1 | 0 |
| 37 | | | "Bachelor" në "Histori-Gjeografi" | 46 | 30 | 20 | 3 | 2 | 0 | 1 | 1 | 1 | 2 |
| 38 | | | "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor " | 39 | 25 | 17 | 2 | 2 | 0 | 2 | 1 | 1 | 0 |
| 39 | | | "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte" | 107 | 38 | 30 | 3 | 2 | 0 | 1 | 0 | 2 | 0 |
| 40 | | | "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" | 43 | 26 | 15 | 5 | 3 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 41 | | | "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" | 85 | 51 | 43 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 42 | | | "Bachelor" në "Gjuhë dhe Kulturë Frenge" | 22 | 20 | 13 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 43 | | | "Bachelor" në "Gjuhë- Letërsi" | 51 | 35 | 20 | 5 | 3 | 0 | 2 | 2 | 2 | 1 |
| 44 | | | "Bachelor" në "Gjuhë - letërsi shqipe dhe gjuhë pakicash" | | | | | | | | | | |
| 45 | | | "Master Profesional" në "Mesues për Arsimin Fillor" | 55 | 25 | 20 | 2 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 46 | | | "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin Special" | 30 | 25 | 10 | 15 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 47 | | | "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Histori-Gjeografi" | 37 | 30 | 15 | 7 | 2 | 0 | 1 | 2 | 2 | 1 |
| 48 | | | "Master i Shkencave" në "Mësues i Gjuhës Angleze" | 57 | 45 | 25 | 10 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 5 |
| 49 | | | "Master i Shkencave" në "Mësuesi për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi" | 39 | 30 | 20 | 5 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 50 | | | "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet" | 57 | 25 | 20 | 2 | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| 51 | | | "Master i Shkencave" në "Kulturë, Media dhe Editim" | 35 | 20 | 17 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 52 | | | "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore dhe Etnokulturore në rajonin e Ballkanit" | 6 | 6 | 3 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 53 | | | Program profesional 2- vjeçar "Menaxhim Biznesi Bujqësor" | 63 | 35 | 25 | 2 | 1 | 0 | 2 | 3 | 1 | 1 |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 54 | Fakulteti i Bujqësisë | Program profesional 2- vjeçar "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" | 35 | 25 | 19 | 1 | 1 | 0 | 1 | 2 | 1 | 0 |
| 55 | | Program profesional 2- vjeçar "Menaxhim Veterinar" | 59 | 30 | 25 | 2 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 56 | | "Bachelor" në "Teknologji Ushqimore" | 57 | 30 | 20 | 5 | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 | 2 |
| 57 | | "Bachelor" në "Menaxhim Agrobiznesi" | 45 | 30 | 22 | 5 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| 58 | | "Bachelor" në "Inxhinieri Agronomike" | 36 | 25 | 20 | 1 | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| 59 | | "Master Profesional" në "Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë" | 15 | 15 | 10 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 60 | | "Master Profesional" në "Cilësia dhe Siguria Ushqimore" | 25 | 25 | 20 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 61 | | "Master Profesional" në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm"(Program i përbashkët) | 25 | 25 | 12 | 5 | 1 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 62 | | "Master Profesional" në "Drejtim Agrobiznesi" | 25 | 25 | 15 | 5 | 2 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| 63 | | "Master i Shkencave" në "Shkenca Bujqësore" | 30 | 15 | 10 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 64 | | "Doktoratë" në "Hortikulturë e Qëndrueshme" | | | | | | | | | | |

***** janë programe të reja studimi të aplikuara në e-Albania për vitin akademik 2026-2027***

**** janë programe studimi të aplikuara për riorganizim në e-Albania për vitin akademik 2026-2027***

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1464 prot** **Korçë, më 10 / 08 / 2026**

**VENDIM**

**Nr. 345, datë 10.08.2026**

**PËR**

**DHËNIEN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" PROF. DR. GENCI ÇAPIT**

Bazauar në VKM nr. 112, datë 23.2.2018, kreu V, pika 1, i ndryshuar, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", neni 42, pika 1, si dhe me pëlqimin e MAS, dhënë me shkresën nr. 5134/5, datë 15.7.2026, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli, në mbledhjen online të datës 10.08.2026,

**VENDOSI:**

1. T'i japë titullin **"Doctor Honoris Causa"**, shoqëruar me Medaljen e Artë, prof. dr. Genci Çapit, ekspertit në fushën e robotikës dhe inteligjencës artificiale, me këtë motivacion:

**"Për bashkëpunimin e ngushtë me Universitetin "Fan S. Noli", duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në universitet me një ekspertizë ndërkombëtare në inteligjencë artificiale dhe robotikë përmes projekteve READ, duke trajnuar studentët dhe stafin akademik në teknologjitë më të avancuara, çka është themelore në zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave si dhe në veprimtari të kërkimit shkencor në lidhje me teknologjitë bashkëkohore dhe sistemet inteligjente. Gjithashtu Prof. Genci Çapi ka mbështetur zhvillimin e infrastrukturës kërkimore dhe të projekteve bashkëpunuese ndërdisiplinore, duke forcuar kapacitetet akademike dhe potencialin inovativ të universitetit.**

**Në shenjë mirënjohjeje nga stafi akademik, studentët dhe drejtuesit e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë".**

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1633 prot** **Korçë, më 10 / 09 / 2026**

**VENDIM**

**Nr. 380 , datë 10.09.2026**

**PËR**

**MIRATIMIN E DATËS SË KONKURRIMIT TË DYTË PËR PRANIMET NË PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE"**

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", në Urdhrin e përbashkët nr. 108, datë 15.06.2026 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2026-2027*", si dhe në "*Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte""*, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.09.2026,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë datën **15 shtator 2026**, si datë për zhvillimin e konkursit të dytë për testet praktike të kandidatëve, për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1327 prot.** **Korçë, më 02.07.2026**

**VENDIM**

**Nr. 307, datë 02.07.2026**

**PËR**
**ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 36 pika 7, neni 38 pika 1, gërma gj, neni 48 pika 1, si dhe në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", neni 18 pika 17, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për anëtar Bordi të Administrimit në mbledhjen e datës 02.07.2026,

**VENDOSI:**

1. Të zgjedhë si përfaqësues të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë për një mandat 5-vjeçar, tre kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, si më poshtë:

   - Prof.as.dr. Mirela Cini
   - Prof.as.dr. Alba Osman
   - Dr. Nikolin Karapanço

2. Ky vendim hyn në fuqi në **datën 7 korrik 2026**.
3. Ky vendim t'i përcillet Bordit të Administrimit dhe Drejtorisë së Financës.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 1326 **prot** **Korçë, më** 02 / 07 **/ 2026**

**VENDIM**

**Nr.** 306 **, datë** 02.07 **.2026**

**PËR**

**MIRATIMIN E DATËS SË KONKURRIMIT, PËR PRANIMET NË PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE"**

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", në Urdhrin e përbashkët nr. 108, datë 15.06.2026 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2026-2027*", si dhe në "*Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte""*, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.07.2026,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë datën **14 gusht 2026**, si datë për zhvillimin e konkursit praktik për testet praktike të kandidatëve, për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
2. Sekretaria e departamentit brenda datës **5 gusht 2026** afishon në mjediset e Universitetit listën e aplikantëve nga U-Albania dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve në konkurs.
3. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin do të jenë **5-11 gusht 2026**.
4. Në datën **12 gusht 2026,** sekretaria e departamentit shpall listën e aplikantëve të regjistruar për konkurrim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1325 prot** **Korçë, më 02 / 07 / 2026**

**VENDIM**

**Nr. 305, datë 02.07.2026**

**PËR**

**NGRITJEN E KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE", VITI AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", në Urdhrin e përbashkët nr. 108, datë 15.06.2026 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2026-2027*", si dhe në "*Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte"*", Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.07.2026,

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e komisionit të konkursit të testit praktik të kandidatëve për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte":
   - Doc. Marjela Burda
   - Msc. Julian Shishi
   - Msc. Pandush Tasellari
   - Msc. Markelian Pambuku
   - Dr. Romeo Terolli (personel ndihmësakademik me karakter administrativ)
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të konkursit përcaktohen në "Rregulloren për zhvillimin e konkurisit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof.dr. Lorenc Ekonomi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1324 prot** **Korçë, më 02/ 07/ 2026**

**VENDIM**

**Nr. 304, datë 02.07.2026**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE", SI DHE TESTEVE PRAKTIKE PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), në Statutin e Universitetit, neni 18, pika 6, Urdhrin e përbashkët nr. 108, datë 15.6.2026 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2026-2027*", Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.07.2026,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren "Për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
2. Miratimin e testeve praktike të konkursit për pranimin e kandidatëve sipas modeleve bashkëlidhur.
3. Raporti i pikëve të fituara në konkurrimin praktik dhe notës mesatare do të jetë **40%** për notën mesatare dhe **60%** për testet praktike.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S . NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

# RREGULLORE

# PËR

# ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR", NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE"

**(Miratuar me Vendimin nr. 304, datë 02 / 07 / 2026, të Senatit Akademik të UK-së)**

## Neni 1
## Objekti i Rregullores

Kjo rregullore ka për objekt:

a. Përcaktimin e kritereve dhe procedurave për pranimin e kandidatëve nëpërmjet konkurrimit, në programin e studimit "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte".
b. Përcaktimin e mënyrës së ngritjes së komisioneve të konkursit.
c. Përcaktimin e kritereve të testit praktik dhe mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

## Neni 2
## Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të nenit 74 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*; nenit 55 të Statutit; nenit 46 të Rregullores së Universitetit "Fan S. Noli" Korçë; pikës 10 të Rregullores së programit të studimit "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte", si dhe urdhrin përkatës të MAS.

## Neni 3
## Kriteret e pranimit

1. Pranimi i kandidatëve në programin e studimit "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte" do të bëhet nëpërmjet konkursit.
2. Të drejtën për konkurrimin praktik në këtë program studimi e fitojnë:
   a. Kandidatët që kanë aplikuar nëpërmjet portalit U-Albania, në programin e studimit "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte", mbi bazën e notës mesatare sipas VKM-së në fuqi.
   b. Kandidatët që kanë plotësuar kartelën mjekësore.
3. Kandidatët vlerësohen me pikët e grumbulluara bazuar në rezultatin e testit praktik të UNIKO-së dhe notës mesatare të shkollës së mesme sipas VKM-së në fuqi.

## Neni 4
## Ngritja e komisionit të konkursit dhe detyrat e tij

1. Komisioni i konkursit ngrihet me vendim të njësisë bazë dhe përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë, nga të cilët:
   - Jo më pak se 4 (katër) anëtarë staf akademik me kohë të plotë/të pjesshme, të cilët janë pjesë e njësisë bazë që ofron programin e studimit dhe mbulojnë disiplina sportive;
   - Një përfaqësues nga personeli ndihmësakademik me karakter administrativ,
2. Komisioni:
   -Kryen verifikimin e identitetit të kandidatëve, zhvillimin e testit praktik dhe vlerësimin sipas kritereve të miratuara.
   -Mban procesverbalin e zhvillimit të konkursit.
   -Shpall rezultatet përfundimtare të konkursit.
   -Ofron mbështetje logjistike për zhvillimin normal të konkursit.
   -Shqyrton ankesat e kandidatëve sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi i rezultateve përfundimtare firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.

## Neni 5
## Procedurat e konkurrimit



Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@unkorce.edu.al

1. UNIKO shpall listën e kandidatëve që kanë aplikuar sipas afateve të përcaktuara në udhëzimin përkatës.
2. Data e zhvillimit të konkursit propozohet nga njësia bazë dhe miratohet nga senati akademik.
3. Njoftimi për zhvillimin e konkursit ku përcaktohet vendi, ora, data, shpallet jo më vonë se një javë nga data e konkursit.
4. Lejohen të hyjnë në konkurrim vetëm kandidatët e listës zyrtare të shpallur, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokumentet e mëposhtme:
   a. Dokument identifikimi;
   b. Raport mjeko-ligjor të nënshkruar dhe vulosur nga KML, sipas kartelës individuale shëndetësore.[1]
5. Kandidatët që nuk kanë dokumentet e mësipërme nuk do të pranohen në konkurrim.
6. Para fillimit të tëstit praktik, kandidatëve ju komunikohen rregullat e konkursit.
7. Sekretaria e njësisë bazë i dorëzon me procesverbal listën e kandidatëve kryetarit të komisionit.
8. Ditën e konkursitt, konkurruesit i jepet kartela personale e konkurrimit në të cilën i shënohen rezultatet e arritura në testet e zhvilluara.

**Neni 6**
**Përmbajtja e testeve praktike**

1. Testet praktike hartohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga senati akademik i Universitetit "Fan S. Noli".
2. Testet e konkursit praktik publikohen para datës së konkurrimit në faqen zyrtare të internetit të UNIKO-së.
3. Kandidati ka të drejtë të kryejë 2 teste praktike:
   a. Kërcim së gjati nga vendi (2 prova).
   b. Cirkuiti (1 provë).
4. Në rastet kur ka një numër të konsiderueshëm kandidatësh komisioni harton grafikun e seancave të zhvillimit të testit.

**Neni 8**
**Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve**

1. Sistemi i vlerësimit dhe pikëzimit përcaktohen në modelin e testeve të miratuara nga senati akademik, nga ku 60 % – rezultati i testit praktik; 40 % – nota mesatare e arsimit të mesëm.
2. Nëse kandidati nuk merr pikët e mjaftueshme, nuk shpallet fitues dhe nuk regjistrohet për të ndjekur studimet.
3. Gjatë konkurrimit individual të kandidatëve, anëtarët e komisionit mbajnë shënimet përkatëse.
4. Komisioni, në përfundim të vlerësimeve përpilon listën e kandidatëve dhe pikët përkatëse në bazë të rezultateve të konkurrimit, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe i dorëzohet përgjegjësit të njësisë bazë.
5. Lista përfundimtare me pikët përkatëse për çdo kandidat firmoset nga përgjegjësi i njësisë dhe shpallet jo më vonë se 24 orë pas përfundimit të konkurrimit.
6. Një kopje e listës përfundimtare dërgohet në portalin U-Albania sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës.

**Neni 9**

[1] Shtojca 1 Kartela individuale shëndetësore.



Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@unkorce.edu.al

**Procesi i ankimimit**

1. Secili konkurrent ka të drejtën e ankimimit me shkrim për rezultatin pranë komisionit të konkursit 24 orë pas shpalljes së rezultateve.
2. Ankimimi shqyrtohet brenda një afati 24 orësh nga ankimimi edhe nëse kjo datë është ditë pushimi.
3. Komisioni, pas shqyrtimit të ankesës paraqet procesverbalin dhe vendimin përfundimtar për vlerësimin e ankesës.

**Neni 10**
**Dispozita të fundit**

1. Nëse ka kandidatë që konkurrojnë në dy ose më shumë programe studimi dhe konkursi zhvillohet në të njëjtën kohë, kandidati paraqet një kërkesë me shkrim te dekani i fakultetit për t'i mundësuar paraqitjen në të gjitha konkurrimet.
2. Testet kryhen vetëm një herë. Nëse testi ndërpritet qëllimisht apo kryhen gjeste antisportive, nuk mund të rifillohet rishtas.
3. Për problematika të veçanta gjatë procesit të konkurrimit, komisioni ka të drejtën e vendimmarrjes.
4. Kjo vendimmarrje do të pasqyrohet në një procesverbal të veçantë në momentin e vendimit duke shpjeguar argumentet përkatëse.

## Neni 116
## Hyrja në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon rregulloren e mëparshme dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik.



Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@unkorce.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1323 prot Korçë, më 02 / 07 / 2026

VENDIM

Nr. 303 , datë 02.07.2026

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO PROGRAM STUDIMI DHE TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN PARAPRAK PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Mbështetur, në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 për "*Miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë*", të ndryshuar, në VKM nr. 866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "*Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016*", si dhe në VKM nr. 778, datë 26.12.2018, "*Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë*", të ndryshuar, pika 1 gërma a), Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.07.2026,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2026-2027 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit.
2. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të regjistrimit paraprak 1,600 lekë për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lekë për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lekë për program të dytë studimi.

3. Tarifa e regjistrimit për konkurrim në programin e studimit “Bachelor” në “Edukim fizik dhe sporte” do të jetë 5000 lekë/student.
4. Tarifa e regjistrimit paraprak do të jetë 5000 lekë/student në programet e Doktoraturës.
5. Tarifa e rilëshimit të suplementit të diplomës do të jetë 1000 lekë/suplement diplome.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof.dr. Lorenc Ekonomi**

Shëtitorja “Rilindasit”, Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

| TARIFAT E STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i programit të studimit | Lloji i programit (Bachelor/ Master Profesional/ Master i Shkencave, Program Profesional, Doktoratë, etj.) | Nr. kredite të programit të studimit | Tarifa vjetore e studimit | |
| | | | | Program i parë studimi | Program i dytë studimi |
| 1 | Gjuhë - Letërsi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 35000 |
| 2 | Gjuhë - letërsi shqipe dhe gjuhë pakicash | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 35000 |
| 3 | Gjuhë dhe Kulturë Frënge | Bachelor | 180 ECTS | 15,000 | 15,000 |
| 4 | Gjuhë Angleze | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 5 | Mësuesi për Arsimin Fillor | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 6 | Mësuesi për Arsimin Parashkollor | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 7 | Edukim fizik dhe sporte | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 40,000 |
| 8 | Histori-Gjeografi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 30,000 |
| 9 | Shkenca Politike | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 10 | Matematikë-Fizikë | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 11 | Data Science | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 12 | Biologji- Kimi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 13 | Inxhinieri Informatike | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 40,000 |
| 14 | Teknologji Informacioni | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 15 | Infermieri e përgjithshme | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 120,000 |
| 16 | Mami | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 100,000 |
| 17 | Administrim dhe Politika Sociale | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 18 | Financë - Kontabilitet | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 40,000 |
| 19 | Menaxhim | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 20 | Administrim Biznesi në Marketing | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 21 | Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 22 | Teknologji Ushqimore | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 30,000 |
| 23 | Menaxhim Agrobiznesi | Bachelor | 180 ECTS | 15,000 | 25,000 |
| 24 | Inxhinieri Agronomike | Bachelor | 180 ECTS | 15,000 | 25,000 |
| 25 | Informatikë Biznesi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 26 | Ekonomiks | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 27 | Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 28 | Menaxhim Biznesi Bujqësor | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 29 | Teknika e prodhimit të farave dhe fidanëve | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 30 | Menaxhim veterinar | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 31 | Shërbim Social | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 32 | Mbështetës zyre për komunikimin, bibliotekë dhe arkivë | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 33 | Asistent Menaxher | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 34 | Mësuesi për Arsimin Special | Master Profesional | 120 ECTS | 60000 | 72000 |
| 35 | Mësues për Arsimin Fillor | Master Profesional | 120 ECTS | 60000 | 72000 |
| 36 | Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 37 | Infermieristikë | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 38 | Financë - Kontabilitet | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 39 | Menaxhim i turizmit atraksioneve dhe eventeve | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 40 | Administrim Biznesi | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 41 | Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 42 | Drejtim Agrobiznesi | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 43 | Administrim Publik | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 44 | Bankë dhe Sigurime | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 45 | Inxhineri Agrare Profil Hortikulturë | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 46 | Cilësia dhe Siguria Ushqimore | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 47 | Marketingu Digjital | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 48 | Mësuesi për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 49 | Mësuesi në Gjuhën Angleze | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 50 | Mësuesi në Histori - Gjeografi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 51 | Mësuesi në Shkencat Sociale | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 52 | Mësuesi në Matematikë-Fizikë | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 53 | Mësuesi në Biologji-Kimi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 54 | Mësuesi në Edukim fizik, sport dhe shëndet | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 55 | Etika dhe Lidershipi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 56 | Financë | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 57 | Kulturë, Media dhe Editim | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 58 | Shkencat Bujqësore | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 59 | Shkenca Kompiuterike | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 60 | Statistikë e Aplikuar | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 61 | Turizmi Smart dhe Zhvillimi Rajonal | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 62 | Studime Gjuhësore dhe Etno-Kulturore në Rajonin e Ballkanit | Doktoratë | | 130000 | - |
| 63 | *Teknologji të Avancuara dhe Zbatime të Inteligjencës Artificiale në Kërkimin Ndërdisiplinor | Doktoratë | | 130000 | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 64 | Programi i studimit në formimin psokopedagogjik | Program i formimit të vazhduar | 35 ECTS | 35000 | - |

**** Shënim: Studentët përsëritës në programet e ciklit të dytë do të paguajnë të njëjtën tarifë për kredit, njësoj si studentët e rregullt.***
***Tarifa e regjistrimit paraprak 1600 lekë/student në programet Bachelor dhe Profesionale***
*Tarifa e regjistrimit paraprak 2500 lekë/student në programet e studimit Master*
*Tarifa e regjistrimit paraprak 3000 lekë/student në programet e dyta të studimit*
*Tarifa e regjistrimit paraprak 5000 lekë/student në programet e Doktoratës*
